



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:266694

Datë: 05.04.2022

Numri i dokumentit: 02883858

PKR.nr.203/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me gjyqtaren Violeta Husaj-Rugova me pjesëmarrjen e sekretares juridike Bute Ramosaj si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Sh.I nga P ne rrugën “.....”, për shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par. 1 te KPRK-se, i akuzuar sipas aktakuzës së PTH –së në Pejë, PP/L.nr. 216/21 të dt. 10.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në prezencë të Prokurores së shtetit Lumturije Vuçetaj të akuzuarit Shk.I si dhe mbrojtësi i tij av. Bujar Berdynaj, me dt. 01.04.2022 mori dhe publikisht shpalli, dhe me dt.05.04.2022 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

Sh.I, i lindur me dt., në P ku dhe jeton ne rrugën “”, nga i ati A dhe e ëma F, e gjinisë S, ka të kryer shkollën e mesme i martuar babë i 3 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, punon ne gjermani qe tre muaj, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. personal....., Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë ka siguruar e gjer me dt. 26.08.2021, rreth orës 15:10, në oborrin e shtëpisë së tij,....., , në kundërshtim me nenin 4 par.1 pika 1.1.9 të ligjit të zbatueshëm për armët, (05/L-022) si armë e zjarrit e ndaluar për civil, mban në pronësi armë, në atë mënyrë që, pas pranimit të informatës së i njëjti ishte përfshirë në një rast tjetër penal ku ishte përdorur edhe armë e zjarrit, policia kishin identifikuar dhe proceduar të njëjtin, i cili kishte pranuar se kishte në pronësi një (1) pistoletë me gaz “C.D.E”, kalibër: 9mm P.A.K., me nr. serik: ..., një (1) karikator të së njëjtës armë dhe dy (2) copë fishekë, kalibër 9mm, me gaz, të cilën armë e kishte fshehur në mbi gomën e pasme, ana e djathtë, të automjetit .., ngjyrë hiri, me targa: ..-... dhe e cila i është konfiskuar pasi për të njëjtën nuk posedonte leje përkatëse,

-me çka ka kryer veprën penale “**Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve**”, nga neni 366, par. 1, të KPRK-së.

Andaj , gjykata konform nenit 7,17 par.1,38,39,40,43, nenit 69, 70,71, nenit 366 par.1 , te KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të akuzuarin :

E GJYKON

Për vepër penale si në dispozitivin të cekur më lartë, të akuzuarit i cakton dënim me gjobë në lartësi prej 350€ (treqind e pese dhjete euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 3 muajve nga data e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari i lartcekur dënimin nuk e paguan dënimin me gjobë në afat të caktuar, atëherë i njëjti do ti zëvendësohet me dënim burgu duke iu llogaritur një ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro të gjobës).

Të akuzuarit i konfiskohet: një (1) pistoletë me gaz “C.D.E”, kalibër: 9mm P.A.K., me nr. serik: ..., një (1) karikator të së njëjtës armë dhe dy (2) copë fishekë, kalibër 9mm, me gaz. Të njëjtat gjinden në ruajtje sipas rastit policor-...-..., dhe të njëjtat pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohen.

I akuzuari obligohet që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€(njëzet euro), si dhe shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro) në emër të kompensimit të viktimave, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr. 216/21 të dt. 10.12.2021, kundër të akuzuarit Sh.I nga P, për shkak veprës penale mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim ose shfrytëzim te paautorizuar te armëve nga neni 366 par. 1 te KPRK-se.

Prokuroria para se të lexoj aktakuzën ka bërë korrigjimin e përshkrimit faktik të veprës penale duke shtuar në rreshtin e dytë të dispozitivit të aktakuzës pas shenjës së pikësimit ku duhet të jetë “në kundërshtim me nenin 4 par. 1 pika 1.1.9 të ligjit të zbatueshëm për armët (05/L-022) si armë e zjarrit e ndaluar për civil. Pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 01.04.2022, gjykata është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën dhe të drejtat e tij dhe të akuzuarit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për fajësinë.

I akuzuari Sh.I ka deklaruar se: - pasi që i kam kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimi të fajësisë të cilat më janë shpjeguar nga ana e gjykatës e pranoj fajësinë për vepër penale për te cilën akuzohem.

Prokurorja e shtetit ka deklaruar se: - pajtohem me pranimin e fajësisë meqenëse një pranimi tillë është i bazuar ne shkresat e lendes, dhe i njëjti e ka pranuar në të gjitha fazat e procedurës, kështu që i propozoj gjykatës që të njëjtën ta aprovoj.

Mbrojtësi i të akuzuarit av. Bujar Berdynaj ka deklaruar se: - pajtohet me pranimin e fajësisë dhe gjykata ta merr si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, gjendjen e tij ekonomike, nga se është mbajtës i 7 anëtarëve te familjes se tij, e po ashtu gjykata te merr parasysh se kjo është armë me gaz, andaj ti shqipton një dënim minimal.

Në vijim gjykata duke shqyrtuar fajësinë nga ana e të akuzuarit vlerësoi se pranimi i fajësisë paraqet shprehje të lirë të vullnetit të akuzuarit pasi që i njëjti i ka kuptuar pasojat dhe përparësitë e pranimit të fajësisë dhe se pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Duke pasur parasysh të lartcekurat gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe ka vërtetuar se nuk ekziston ndonjë rrethanë për hudhje të aktakuzës konform nenit 253 të KPPRK-së, se janë plotësuar kushtet nga neni 248 të KPPRK-së, atëherë në këtë çështje nuk është zbatuar procedura e provave.

Gjykata e ka shpall fajtor të akuzuarin bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe bazuar në provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: Raporti i hetuesit T.H #.., i përpiluar me dt. 26.08.2021, Deklarata e të dyshuarit Sh.I, e dhënë pranë Stacionit Policor – Njësi i Hetimeve – P., me dt. 26.08.2021, Fotografi nga vendi i ngjarjes dhe fotografi të mjetit të gjetur dhe të konfiskuar, Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i përpiluar nën nr. të rastit: ...-...-..., dt. 26.08.2021, Lista e dëshmitarëve, e përpiluar nën nr. të rastit: ...-...-..., dt. 26.08.2021, Një (1) CD, videoincizim nga vendi i ngjarjes, deklarata e të pandehurit SH.G e dhënë në Prokurori me dt. 01.12.2021, si dhe shkresat tjera të lëndës.

Duke vendosur mbi vendimin mbi dënim gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat për dënimin konform nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoj se i akuzuari e ka pranuar fajësinë që në shqyrtim fillestarë, pendimin e tij dhe premtimin se nuk do të përsëriten veprime të tilla, pastaj rrethanat e tij familjare se është mbajtës i familjes ka 3 fëmijë. Gjykata i ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka një rast të hapur në procedurë për lëndim të lehtë trupor, por duke pas parasysh se është vetëm një rast dhe ende nuk është i përfunduar gjykata nuk e mori si rrethanë rënduese pasi që bëhet fjalë për vepër penale si pasojë e së cilës është gjetur edhe arma.

Andaj gjykata duke u gjendur para rrethanave lehtësuese të cekura si më lartë dhe në mungesë të rrethanave rënduese, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit, siç është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprës penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale, gjithnjë duke u bazuar në nenit 38 të KPRK-së.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK-së të akuzuarit i janë konfiskuar arma dhe municioni të cekura në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe e njëjta pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi do të shkatërrohet.

Gjykata konform nenit 450 të akuzuarin e obligon në paguarjen e paushallit gjyqësorë.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarin që ti paguaj në emër të kompensimit të viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPPRK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË

**DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,
2021:266694, 05.04.2022**

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.